

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

PRIMUS ALBANIA

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L42202028V

NUIS/NIPT

Rruga Margarita Tutulani, pallati Viridario 1

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0697073123

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@primus.com.al

E-mail

Administrator Hrvoje Cabrajic

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/10/12

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0697073123

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-82854-10-09-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SH.A

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

6000000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

‘‘Sherbim Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj’’.

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/10/23

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2023/10/23

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/83120/10092023

50312310-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Dokumentet Standarte të Tenderit

Proces-verbali “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim”

Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavarshmërinë)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Në datë 10.10.2023 në SEP të APP identifikua publikimin e procedurës së prokurimit nr. REF-82854-10-09-2023 me objekt prokurimi “Shërbim Mirëmbajtje e Programit të Faturimit Flare Billing për 12 muaj”, me fond limit 6,000,000 lek publikuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër Sh. A. Afati i dorëzimit të ofertave është data 23.10.2023, ora 10:00.

Duke identifikuar parregullsi në dokumentet e tenderit (DST), po kërkojmë sipas rastit heqjen/ riformulimin/modifikimin e tyre.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

I. Në Njoftimin e Kontraës pjesë e DST në paragrafin 3.1.3 Autoriteti Kontraktor nuk ka përzgjedhur asnjë nga dy opsionet e parashikuara për Sigurimin e Ofertës, si më poshtë:
3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare ?

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente ?

Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 83, pika 2 si më poshtë:

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlloritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin/modifikimin e kësaj të dhëne.

II. Në shtojcën 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, në tabelën, në kolonën “Vendi i ekzekutimit” keni përcaktuar “Sipas Specifikimeve teknike”, si më poshtë:

Shërbimet	Përshkrimi	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
-----------	------------	---------------------	---------------------

1	Mirembajtje e Programit të Faturimit Flare Billing për 12 muaj	Sipas Specifikimeve teknike	Sipas Specifikimeve teknike
---	--	-----------------------------	-----------------------------

Ndërkohë në Shtojcën 5 Specifikimet Teknike nuk keni përcaktuar vendin e ekzekutimit të shërbimeve.

Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin/modifikimin e kësaj të dhëne.

III. Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë) e perditesuar
- b) ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) e perditesuar
- c) ISO 20000 (manaxhimi i shërbimeve IT), e perditesuar, e cila duhet te perkoje me kategorine dhe specifiken e produkteve dhe te shërbimeve qe prokurohen.
- d) BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve te integruar) e perditesuar

Këto certifikime të kërkuara, lëshuar nga organizma certifikues, sipas datës së vlefshmërisë së tyre ose janë të vlefshme ose i ka kaluar afati i vlefshmërisë në datën e përdorimit të tyre për procedurën e prokurimit referencë, ndaj cilësimi i tyre “e përditësuar” është e pakuptimtë dhe mund të krijojë keqinterpretime.

Vetë kodi i tyre dhe objekti të cilin ju keni formuluar për çdo certifikatë të listuar jep në mënyrë shteruese dhe paekuivok llojin e certifikatës që ju kërkonte.

Lidhur me këtë pasaktësi nga ana juaj po ju kujtojmë se Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është shprehur si më poshtë me vendimin e tij nr. 386/2023:

?

Lidhur me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, përse i përket termi “e përditësuar” në lidhje me certifikatat ISO të kërkuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 të Shtojcës 8 “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2, duke hequr termin “e përditësuar”, pasi vendosja e këtij termi është në tejkalim të përcaktimeve të nenit 44 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe vlefshmëria e certifikatave të sipërpërmendura është objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të dorëzuara sipas parashikimeve të nenit 82 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Përse më sipër kërkojmë heqjen e termi “e përditësuar” pas certifikatave të listuara më lart.

IV. Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë te punesuar te pakten 4 punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve. Keta punonjes duhet te jene te certifikuar si vijon:

a. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Çertifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes qe AK ka ne perdorim.

- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesit

Lidhur me këtë kriter kemi paqartësitë/objeksionet e mëposhtëme:

Në këtë kriter, në Shtojcën 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, por edhe në asnjë fjali të DST nuk është dhënë si informacion teknologjia/gjuha e programimit e përdorur për të krijuar/implementuar

programin që autoriteti kontraktor ka aktualisht në përdorim. Në këto kushte kushdo operator ekonomik (përveç autorit të programit) e ka të pamundur për mungesë informacioni të propozojë punonjësit e çertifikuar “në zhvillim dhe implementim e zgjidhjes që AK ka në përdorim”, pasi mungon informacioni bazë, kush është teknologjia/gjuha e programimit e përdorur për të krijuar/ implementuar programin.

Ndërkohë në proces-verbalin e argumentimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike ju keni argumentuar lidhur me këtë kriter:

a. Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar si “Ekspert të Çertifikuar” në zhvillim dhe implementim e zgjidhjes së faturimit që AK ka në përdorim.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit

Argumentim: Që të sigurohet një mirembajtje sa më efiçente e Programit të Faturimit që shoqëria ka në përdorim, zgjidhja në kohe e problemeve, etj, kërkohej që Operatori Ekonomik të ketë të punësuar të pakten 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze të sistemit.

Punonjësi i certifikuar në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes që shoqëria ka në përdorim “Flare Billing” bënte të mundur që zgjidhjet e problemeve të behen brenda afatëve të percaktuara në SLA dhe në këtë mënyrë të mos krijohet asnjë problematikë në sistemin e faturimit. Në këtë mënyrë AK ka garancinë që të njihet mirë sistemi aktual i faturimit dhe të mos krijohet asnjë problematikë që mund të sjellë ndërprerje të proceseve të rëndësishme të faturimit dhe në këtë mënyrë të AK të arketohet pagesat e kryera. Ekspertët e certifikuar bëjnë të mundur që realizimi i kontratës dhe specifikimeve të saj të jetë sa më i plotë, shtrues dhe në afatet e percaktuara duke bërë të mundur mbarvajtjen normale të procesit të punës.

Pra, në argumentim ju citoni se punonjësi duhet të jetë i certifikuar në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes që shoqëria ka në përdorim “Flare Billing”, duke ju referuar një produkti të gatshëm por edhe këtu pa saktësuar se kush është teknologjia/gjuha e programimit e përdorur për krijimin/implementimin e programit.

Lenia evasive dhe e papërcaktuar e teknologjisë/gjuhës të programimit të përdorur për të krijuar/ implementuar programin do të thotë mungesë e plotë informacioni dhe paqartësi, informacion, që do t’i krijonte mundësi dhe hapësira operatorëve ekonomikë në përmbushjen e këtij kriteri.

Kjo është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 77 Kërkesat për Kualifikim, pika 5, citojmë si më poshtë:

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Në rastin konkret ju keni përcaktuar kriterin e përzgjedhjes, por nuk keni përdokumentin/et konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë.

Kujtojmë se plotësimi/modifikimi i këtij kriteri do duhet bërë duke patur parasysh vendimin e KPP nr. 277/2022 që shprehet si më poshtë:

?

Komisioni gjykon se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, që operatorët ekonomikë ofertues disponojnë stafin me aftësitë dhe ekspertizat e duhura për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Por, përcaktimi i certifikatave të lëshuara nga kompani të posaçme, gjuhë programimi dhe për kualifikime mbi produkte të prodhuara nga këto të fundit, kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, si dhe bie në kundërshtim edhe me vetë përcaktimet e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike, ku evidentohet se zgjidhja është lënë në diskrecion të operatorëve ekonomikë. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë kriteret e mësipërme duke mos e përcaktuar titullin e certifikatave apo subjektin lëshues të saj, që nevojiten për të vërtetuar aftësitë e punonjësve, por të përcaktojnë certifikatat bazuar në funksionin dhe nivelin e ekspertizës që duhet të

zotërojnë këta punonjës, me anë të termave funksionale.

Referuar sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me kërkesat ligjore dhe vendimin e KPP.

V. Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten 4 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve. Këta punonjës duhet të jenë të certifikuar si vijon:

b. Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP. Këto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikates perkatesen për punonjës.

Në process-verbalin e argumentimit të kritereve dhe specifikimeve teknike, për këtë kriter ju keni argumentuar si më poshtë:

b. Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP. Këto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikates perkatesen për punonjës.

Argumentim: Specialisti i sipërcituar nevojitet për të garantuar integrimin mes sistemeve të brendshme dhe me sistemet e paleve të treta. Këto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara.

Referuar kriterit dhe argumentimit të tij del e qartë që është kërkuar 1 (një) specialist që të jetë i certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web dhe në protokollin SOAP.

Së pari, kërkesa që një specialist të ketë më shumë se një certifikatë kufizon në mënyrë të padrejtë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, çënon parimet bazë të ligjit të prokurimit publik dhe konkretisht: i) redukton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ii) redukton konkurrencën ndërmjet operatorëve; iii) nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Së dyti, referuar kriterit dhe konkretisht “Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve?”, Shtojcës 5 Specifikimeve Teknike, dhe bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kriteri për disponimin e 1 (një) punonjësi të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve është i ekzagjeruar dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Në Specifikimet Teknike të shërbimit të kërkuar nuk del askund nevoja e AK për shërbime Web. Pra, ky kriter është jo në përpjestim me detyrat që duhet të kryejë Kontraktori në përmbushje të kontratës referencë.

Referuar sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me përcaktimet, kërkesat ligjore dhe natyrën e shërbimeve që kërkohen.

VI. Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën 2.3.4 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar i

zgjidhjes FLARE BILLING që është zgjidhja në përdorim. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në këtë autorizim duhet të përfshihen të dhënat e procedurës: Nr i referencës, Data e procedurës, Objekti i procedurës, Autoriteti Kontraktor. Në çdo rast duhet të paraqitet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

VI/1. Në Shtojcën 5. Formulari i Specifikimeve Teknike, ndër të tjera ju keni informuar:

I. Hyrje

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster operon në një shtrirje gjeografike të konsiderueshme dhe ka në administrimin e saj 7 njësi administrative dhe përkatesisht Gjirokaster, Tepelene, Memaliaj, Kelcyre, Permet, Libohovë dhe Dropull. Shoqëria menaxhon të gjithë të dhënat e saj si dhe gjeneron faturat e abonenteve me anë të programit të Faturimit Flare Billing i cili operon në Cloud. Ky program është i aksesueshem në të gjithë arkat e njësive administrative të lartepërmenduar si dhe në zyrat e njësive. Numri i madh i operatorëve si dhe numri akoma më i lartë i transaksioneve është shumë e nevojshme mirëmbajtja e këtij sistemi kaq deciziv për Shoqërinë tonë.

II. Objekti i shërbimit

Objekti i shërbimit është mirëmbajtja e programit të Faturimit Flare Billing.

III. Afati i shërbimit

-Afati i shërbimit do të jetë 12 muaj nga lidhja e kontratës.

-Rezultatet që duhet të arrihen.

Mirëmbajtja e programit të Faturimit Flare Billing që ka në përdorim.

Pra, ju, në cilësinë e AK/Shoqërisë i referoheni një marke konkrete për programin e faturimit, konkretisht Flower Billing, që disponon aktualisht AK/Shoqëria.

Po në Shtojcën 5. Formulari i Specifikimeve Teknike pjesë e DT, në hyrje të tyre, ju shprehni:

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 36, Specifikimet teknike, pika 4 ndër të tjera shprehet:

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objektin e kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë

markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Pra, në kërkesën/kriterin tuaj për kualifikim 2.3.4 mungon togfjalëshi “ose ekuivalent” pas togfjalëshit “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar i zgjidhjes FLARE BILLING qe eshte zgjidhja në përdorim?”, ashtu siç kërkon ligji dhe vetë DST.

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 2, Qëllimi, shprehet:

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Vendosja e një kriteri të tillë të paplotë eliminon plotësisht konkurrencën duke i mundësuar ofertimin vetëm autorit të programit të faturimit ose të përzgjedhurit të tij.

Pra, me anë të këtij kriteri është cënuar qëllim i ligjit të sipërcituar.

Për këtë rast sjellim në vëmendje edhe vendimin përgjithësues të KPP nr. 509/2021, citojmë si më poshtë:

?

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është autoriteti kontraktor organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere dhe specifikime që janë në funksion të marrjes së një shërbimi cilësor në rastin konkret por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese për operatorët ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurë. KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislationit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriteret e sipërcituara duke shtuar në çdo rast frazën ekuivalent

VI/2. Në informacionet e publikuara nga APP, konkretisht Regjistrin e Realizimeve dhe në Open Data për vitin 2021, rezultojnë të dhënat e mëposhtëme lidhur me procedurën e prokurimit referencë REF-03357-08-20-2021, organizuar nga ish-Ujësjetës Kanalizime Gjyrokastër sh.a.:

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Ujësjetës Kanalizime Gjyrokastër

Referenca: REF-03357-08-20-2021

Objekti i Prokurimit: Sistem faturimi, arketimi dhe shërbimi mirembajtjes për UK Gjyrokastër

Lloji i Procedurës: Blerje e Vogël

Fondi Limit: 750,000 Lek

Data e Hapjes: 20.05.2021

Data e mbylljes: 23.08.2021

Fituesi: Kreatx sh.p.k.

Vlera e Fituesit: 720,000 Lek

Duke u fokusuar vetëm tek objekti i prokurimit dhe jo të dhënat e tjera të asaj kontrate (si vlera, afati, etj.), bazuar në të dhënat e mësipërme rezultoi që në vitin 2021, ish-Sh.A. Ujësjetës

Kanalizime Gjirokastër ka prokuruar dhe instaluar më pas programin kompjuterik të faturimit që aktualisht përdor sot dhe që kërkon po mirëmbajtjen e tij për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a.

Me prokurimin (blerjen) dhe instalimin e atij programi kompjuterik faturimi ish-Sh.A. Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër ka fituar të drejtat mbi atë program përfshi dhe ndërhyrjen në të për përditësim, mirëmbajtje, etj., pa marrë paraprakisht autorizimin e prodhuesit. Për këtë qëllim krahas programit të instaluar në serverat e tij Kontraktori ka detyrimin të furnizojë AK edhe me Kodin Burim (source code) të programit. Kodi burim i programit mundëson hyrjen në të për zhvillime, përditësim dhe mirëmbajtjen e programit, mjafton profesionalizimi dhe certifikimi i ekspertit që do ndërhyjë. Nëse pranojmë të kundërtën, pra autorizimin në çdo rast të prodhuesit/autorit për të ndërhyrë/mirëmbajtur sistemin/programin, atëhere duhet të pranojmë faktin që mirëmbajtja e të gjitha programeve kompjuterike të krijuara do të kthehej në ekskluzivitet të prodhuesve të tyre, pra do të kishim një treg monopol për çdo program kompjuterik, praktikisht do të zhdukej konkurrenca dhe zhvillimi.

Në dokumentet standarte të tenderit për kategorinë “mallra” në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës LPP parashikon si më poshtë:

1.7 E drejta e autorit

1.7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve. Për paligjshmërinë e vendosjes të markës apo e termit “ekivalent” në kriterin e kualifikimit është shprehur edhe KPP me vendimin e tij nr. 386/2023, faqja 55 dhe 56.

Referuar sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me përcaktimet, kërkesat ligjore dhe vendimin e KPP.

VII. Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën 2.3.5 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.5 Operatori Ekonomik pjesmarres duhet të paraqesë një oferte teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

-Përgjigje një më një të kërkesave teknike të specifikuara në Termat e References.

Shënim: Përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen (duhen përgjigje të argumentuara për çdo kërkesë të parashikuar në Termat e References).

Ju kujtojmë që në fazën procedurale, atë të dorëzimit të ofertave elektronike, kjo kërkesë përmbushet me anë të shtojcës 9. Formluari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, konkretisht:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata Përgjigje

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimittë përcaktuar nga Autoriteti kontraktor. Po [] Jo []

Referuar sa më sipër ne kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme □

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Sipas percaktimeve ligjore

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@primus.com.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Hrvoje Cabrajic

